



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 48

Tiranë – E mërkurë, 1 prill 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 19/2015 datë 12.3.2015	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar..... 2069
Ligj nr. 20/2015 datë 12.3.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit financiar ushtarak ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe protokollit të zbatimit për asistencën financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë..... 2069
Dekret nr. 9002, datë 19.3.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2074
Udhëzim i ministrit të Financave dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 4, datë 16.2.2015	Për kriteret dhe procedurat financiare për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit..... 2075
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 19.3.2015	Me objekt: 1. Shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, të vendimeve nr. 821, datë 19.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 61, datë 25.1.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-50, datë 16.1.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). 2. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë..... 2078
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 19.3.2015	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 00-2014-937, datë 19.6.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 228, datë 15.5.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë..... 2083
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Agim Ragip Uligaj..... 2086



**LIGJ**  
**Nr. 19/2015**

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË  
LIGJIN NR. 7746, DATË 28.7.1993, “PËR  
HIDROKARBURET (KËRKIMI DHE  
PRODHIMI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

**Neni 1**

Në nenin 9, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), kontraktorët që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure, organet e administratës tatimore dhe doganore, si dhe organet e qeverisjes qendrore dhe vendore kanë detyrimin të raportojnë, sipas standardit të caktuar nga kjo Nismë, pranë Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë nxjerrëse, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse publikon të dhënat sipas standardit EITI.”.

**Neni 2**

Në nenin 12, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Marrëveshja “Albpetrol”, e lidhur më 26 korrik 1993, me të gjitha ndryshimet e saj dhe listat e objekteve të operacioneve hidrokarbure, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, do të qëndrojnë në fuqi edhe pas përfundimit të procesit të privatizimit. Marrëveshja “Albpetrol” është një marrëveshje hidrokarbure e veçantë, ku të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje do të vazhdojnë të zbatohen mbi zonat e parashikuara në listat A, B dhe C.

Për zonat ku shoqëria “Albpetrol”, sh. a., kryen operacione e vetme, për të cilat nuk janë lidhur marrëveshje hidrokarbure me shoqëri të treta, shoqëria “Albpetrol”, sh.a., ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure kërkimi, zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi të naftës e të gazit për një afat 25-vjeçar, i cili do të fillojë pas datës efektive të kontratës së blerjes së aksioneve të shoqërisë “Albpetrol”, sh.a., nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë hidrokarbure. Termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje hidrokarbure përcaktohen si shtojcë në marrëveshjen “Albpetrol”. Për sa i përket zonave të parashikuara në listën C, afatet e operacioneve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin rregullohen në marrëveshjet hidrokarbure.”.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.3.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9011, datë 25.3.2015  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 20/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË  
BASHKËPUNIMIT FINANCIAR  
USHTARAK NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË TURQISË DHE  
PROTOKOLLIT TË ZBATIMIT PËR  
ASISTENCËN FINANCIARE NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit financiar ushtarak ndërmjet Këshillit të Ministrave



të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe protokollit i zbatimit për asistencën financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.3.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9012, datë 25.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT  
FINANCIAR USHTARAK  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË**

#### HYRJE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (më poshtë të quajtur “Pala” veçmas dhe “Palët” bashkërisht), me dëshirën për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak brenda fushës së veprimit të marrëdhënieve miqësore afatgjata, si dhe për kontributin për rristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kanë rënë dakord për çështjet e mëposhtme:

#### Neni 1

##### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i bazës së alokimit të bashkëpunimit financiar të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në shumën e dollarëve amerikanë që është e barazvlefshme me 2 275 000 lira turke (dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lira turke), nga të cilat shuma e dollarëve amerikanë e barazvlefshme me 2 145 000 (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë lira turke) ofrohet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga kompani lokale në Turqi, kryesisht nga kompanitë e industrisë ushtarake turke për qëllime ushtarake, dhe shuma që mbetet në dollarë amerikanë e barazvlefshme me 130 000 lira turke (njëqind e tridhjetë mijë lira turke) i ofrohet pas hyrjes në fuqi të Protokollit të zbatimit të asistencës

financiare që do të nënshkruhet pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 2

##### **Fusha e veprimit**

Me këtë Marrëveshje burimi financiar që arrin shumën në dollarë amerikanë të barazvlefshme me 2 145 000 lira turke (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë lira turke) i ofrohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në formë të kontributit financiar për kostot e mallrave dhe shërbimeve që duhet të blihen për qëllime ushtarake nga kompani lokale në Turqi, kryesisht kompanitë e industrisë së mbrojtjes së Turqisë; burimi financiar që arrin shumën në dollarë amerikanë të barazvlefshme me 130 000 lira turke (njëqind e tridhjetë mijë lira turke) do të ofrohet në fushën e veprimit të Protokollit të zbatimit në lidhje me asistencën financiare dhe bazuar në legjislacionin përkatës të Qeverisë së Republikës së Turqisë.

#### Neni 3

##### **Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë në emër të Qeverisë të Republikës së Turqisë. Pikat e kontaktit për këtë Marrëveshje janë Zyra e Atasheut Ushtarak të Republikës së Shqipërisë në Ankara/Turqi dhe Zyra e Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Shqipëri.

#### Neni 4

##### **Parimet e zbatimit**

1. Në rastet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve për qëllime ushtarake nga kompanitë lokale që operojnë në Turqi, kryesisht kompanitë e industrisë së mbrojtjes së Turqisë, me burimin financiar që arrin shumën në dollarë amerikanë të barazvlefshme me 2 145 000 lira turke (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë lira turke):

a) Nëse mallrat dhe shërbimet e blera arrijnë shumën në dollarë amerikanë të barazvlefshme me 2 145 000 lira turke (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë lira turke) dhe më shumë se kjo shumë, atëherë 100% e shumës së dollarëve amerikanë e barazvlefshme me 2 145 000 lira



turke (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë lira turke);

b) Nëse mallrat dhe shërbimet e blera janë më pak se sasia në dollarë amerikanë të barazvlefshme me 2 145 000 lira turke (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë lira turke), 100 % e shumës së vlerës së mallrave dhe shërbimeve të blera,

ofrohen me para në dorë, bazuar në porosinë që jepen nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë për Bankën Qendrore në zbatim të parimeve të Marrëveshjes, nëpërmjet transferimit në llogarinë bankare të kompanisë nga e cila është bërë prokurimi, e caktuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

2. Burimi financiar i alokuar për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të përdoret në bazë të nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje. Shumat e pashpenzuara brenda periudhës së caktuar i kthehen thesarit të Republikës së Turqisë.

3. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dërgon listën e kërkesave të përcaktuara sipas burimit të alokuar (duke mbuluar gjithashtu prioritetet) për Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, para ardhjes në Turqi për blerjet. Nën koordinimin e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë përcaktohen kompanitë përkatëse dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, fillon procesin e blerjes nga kompanitë lokale në Turqi, në veçanti nga kompanitë e industrisë së mbrojtjes së Turqisë.

4. Pagesat kryhen nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë në llogarinë bankare të kompanisë nga e cila është bërë prokurimi, e caktuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

a) Nënshkrimi dhe përmbushja e kontratës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë;

b) Deklarimi me notë diplomatike që mallrat dhe shërbimet e blera nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë janë marrë.

5. Në rast se Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë kryen një blerje që tejkalon burimin financiar të alokuar dhe sasinë e kontributit, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë duhet të transferojë një burim shtesë në kontributin financiar të alokuar. Qeveria e Republikës së Turqisë nuk do të kryejë asnjë pagesë më të lartë se shuma e deklaruar në Marrëveshje. Shuma shtesë

do të paguhet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

6. Shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me alokimin e burimit financiar, si: ngarkesa, transporti, ngarkimi, paketimi, arsimimi, dietat e udhëtimit dhe pagesat ditore, sigurimi, taksat, tarifrat, detyrimet bankare dhe diferencat në kursin e këmbimit valutor, duhet të deklarohen në kontratën e shitjes që lidhet ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë.

7. Vizitat që lidhen me procesin e prokurimit fillojnë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, bazuar në nenin 9 të saj. Shpenzimet e zyrtarëve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që kanë lidhje me këtë proces paguhet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Gjatë zbatimit të transaksioneve të prokurimit, zbatohen dispozitat rregullatore që janë të vlefshme në Republikën e Turqisë; pasi materiali ose shërbimi i dhënë të jenë marrë nga Republika e Shqipërisë, do të zbatohen masat e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

8. Shuma në dollarë amerikanë e barazvlefshme me një asistencë financiare prej 130 000 lira turke (njëqind e tridhjetë mijë lira turke) vihet në dispozicion sipas parimeve të Protokollit të zbatimit të asistencës financiare, i cili do të nënshkruhet veçmas ndërmjet autoriteteve të të dy Palëve të përmendura në këtë Marrëveshjeje.

9. Burimi financiar i alokuar nga Protokollit i zbatimit në lidhje me asistencën financiare transferohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë në llogarinë bankare të Zyrës së Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

### **E drejta e përdorimit për mallrat dhe shërbimet**

1. Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë bie dakord të paguajë të ardhurat e fituara nga përjashtimi i mallrave dhe shërbimeve prej inventarit të blera me burimin financiar që do të transferohet nga ana e Qeverisë së Republikës së Turqisë, në llogarinë bankare që do të caktohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë.

2. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë bie dakord mbi mostransferimin e



mallrave dhe shërbimeve ose të drejtave të përdorimit të tyre ndaj një vendi tjetër apo Pale të tretë, pa marrjen e njoftimit paraprak me shkrim nga Qeveria e Republikës së Turqisë.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojnë tek angazhimet që rrjedhin nga traktatet e tjera ndërkombëtare ku secila prej vendeve është Palë dhe nuk do të përdoren kundër të drejtave, sigurisë dhe integritetit territorial të shteteve të tjera.

Neni 6

#### **Siguria e informacionit të klasifikuar**

Palët nuk deklarojnë përmbajtjen dhe zbatimin e Marrëveshjes ose të informacionit të klasifikuar që mund të shkëmbehet midis Palëve, tek qeveria, shoqëria apo personi i një pale të tretë, pa pëlqimin me shkrim nga Qeveria e Republikës së Turqisë. Ky parim i konfidencialitetit vazhdon të zbatohet edhe pas pushimit të fuqisë së Marrëveshjes.

Neni 7

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të lindë nga zbatimi ose interpretimi i kësaj Marrëveshjeje, mosmarrëveshja nuk do t'i paraqitet ndonjë Pale të Tretë, bordi arbitrazhi apo gjykate ndërkombëtare, por do të zgjidhet me përdorimin e bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike. Nëse nuk arrihet zgjidhje pas negociatave nëpërmjet kanaleve diplomatike ndërmjet Palëve, kjo Marrëveshje do të priset sipas procedurës së përcaktuar në nenin 10.

Neni 8

#### **Rishikimi dhe amendimi**

1. Secila nga Palët mund të propozojë rishikimin apo amendimin e kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast, Palët do të fillojnë diskutimet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e njoftimit me shkrim për çështjen në fjalë.

2. Amendimet e rena dakord me shkrim ndërmjet Palëve hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përshkruar në nenin 9.

3. Nëse nuk arrihet rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i bisedimeve, kjo Marrëveshje do të priset në pajtim me dispozitat e nenit 10.

4. Palët vazhdojnë të plotësojnë detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo Marrëveshje gjatë procesit të bisedimeve.

Neni 9

#### **Ratifikimi dhe hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për mbarimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore që nevojiten për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 10

#### **Kohëzgjatja dhe zgjidhja**

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për 5 (pesë) vjet. Në rast se është përdorur i gjithë burimi financiar që i alokohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, kjo Marrëveshje do të përfundojë në datën e marrjes së njoftimit të dytë me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën për konfirmimin e situatës.

2. Në rastet kur një nga Palët nuk plotëson kushtet ose konstaton se Pala tjetër nuk plotëson dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Palët duhet të propozojnë me shkrim një konsultim midis tyre. Këto konsultime duhet të fillojnë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit me shkrim. Nëse nuk arrihet ndonjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, secila nga Palët mund ta prishë këtë Marrëveshje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

3. Përfundimi i Marrëveshjes për ndonjë arsye nuk ndikon tek dispozitat e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

#### **Teksti dhe nënshkrimet**

1. Kjo Marrëveshje është përgatitur në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, ku secili prej teksteve është njëloj autentik. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të rrjedhë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

2. Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë përfaqësues të autorizuar rregullisht të dy palëve, nënshkruajnë këtë Marrëveshje më 14 maj 2014, qytetin e Tiranës/Republika e Shqipërisë.



Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi :

Emri: Mimi Kodheli

Titulli: Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë

Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë

Nënshkrimi :

Emri: Ismet Yılmaz

Titulli: Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë

**PROTOKOLLI I ZBATIMIT**  
PËR ASISTENCËN FINANCIARE  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë të quajtura veçmas "Pala" dhe bashkërisht "Palët") kanë rënë dakord mbi çështjet e mëposhtme për sa i përket asistencës financiare që jepet në kuadrin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Financiar Ushtarak, të nënshkruar më 16 tetor 2014.

Neni 1

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij protokoll është vendosja e parimeve të zbatimit të asistencës financiare në shumën e dollarëve amerikanë të barazvlershme me 130 000 lira turke (njëqind e tridhjetë mijë lira turke) që do të ofrohen nga Qeveria e Republikës Turke për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

**Fusha e veprimit**

Asistenca financiare që do të ofrohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë përfshin shpenzimet e transportit, ushqimit dhe akomodimit dhe tarifatat e kurseve, si dhe shpenzimet e transportit për vizitat e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të ndjekur kurset e dhëna/të koordinuara nga Qendra e Trajnimit të Partneritetit për Paqe në Turqi dhe Qendrat e Ekselencës, si Mbrojtja nga Terrorizmi dhe Siguria Detare Shumëkombëshe.

Neni 3

**Parimet e zbatimit**

1. Asistenca financiare, që do të transferohet në llogarinë bankare të Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Republikën e Shqipërisë nga Ministra e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë do të shpenzohet nën mbikëqyrjen e Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Republikën e Shqipërisë në kuadrin e udhëzimeve të dhëna nga Shtabi i Përgjithshëm Turk.

2. Burimet e alokuara Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përdoren në pajtim me nenin 8 të këtij protokoll. Pjesa e mbetur i kthehet thesarit turk.

Neni 4

**Siguria e informacionit të klasifikuar**

Palët nuk e deklarojnë përmbajtjen dhe zbatimin e protokollit ose të informacionit të klasifikuar që mund të shkëmbehet ndërmjet palëve, tek qeveritë, firmat ose personat e palëve të treta, pa pëlqimin me shkrim të palës tjetër. Ky parim i konfidencialitetit vazhdon të zbatohet edhe pas pushimit të fuqisë së protokollit.

Neni 5

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast të ndonjë marrëveshjeje që mund të lindë nga zbatimi ose interpretimi i këtij protokoll, mosmarrëveshja nuk do t'i paraqitet ndonjë pale të tretë, bordi arbitrazhi apo gjykate ndërkombëtare, por do të zgjidhet me përdorimin e bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Për sa u përket çështjeve që nuk mbulohen nga ky protokoll, do të zbatohen dispozitat përkatëse të "Marrëveshjes së bashkëpunimit financiar ushtarak", të nënshkruar më 16 tetor 2014.

3. Dispozitat e këtij protokoll nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare të palëve.

Neni 6

**Rishikimi dhe amendimi**

1. Secila nga palët mund të propozojë rishikimin apo amendimin e këtij protokoll. Në këtë rast palët do të fillojnë diskutimet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e njoftimit me shkrim për çështjen në fjalë.



2. Amendimet e rëna dakord me shkrim ndërmjet palëve hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përshkruar në nenin 7.

3. Nëse nuk arrihet rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i bisedimeve, ky protokoll do të priset në pajtim me dispozitat e nenit 8.

4. Palët vazhdojnë të plotësojnë detyrimet e tyre që rrjedhin nga ky protokoll gjatë procesit të bisedimeve.

Neni 7

#### Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

Ky protokoll hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilës palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për mbarimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore që nevojiten për hyrjen në fuqi të protokollit.

Neni 8

#### Kohëzgjatja dhe zgjidhja

1. Ky protokoll do të mbetet në fuqi 5 (pesë) vjet. Në rast se është përdorur i gjithë burimi financiar që i alokohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ky protokoll do të përfundojë në datën e marrjes së njoftimit të dytë me shkrim nëpërmjet të cilave palët njoftojnë njëra-tjetrën për konfirmimin e situatës.

2. Në rastet kur një nga palët nuk plotëson kushtet ose konstaton se pala tjetër nuk plotëson dispozitat e këtij protokoll, palët duhet të propozojnë me shkrim një konsultim midis tyre. Këto konsultime duhet të fillojnë jo më vonë se brenda 30 (tridhjetë ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim. Nëse nuk arrihet ndonjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, secila nga palët mund ta prishë këtë protokoll brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

3. Ky protokoll mbetet në fuqi për sa kohë mbetet në fuqi marrëveshja e bashkëpunimit financiar ushtarak e datës 16 tetor 2014 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë. Ky protokoll mbaron automatikisht në rast se priset Marrëveshja e bashkëpunimit financiar ushtarak e datës 16 tetor 2014 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Neni 9

#### Teksti dhe nënshkrimi

1. Ky protokoll është përgatitur në dy kopje origjinale në gjuhën turke, shqipe dhe angleze, ku secili prej teksteve është njëloj autentik. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të rrjedhë gjatë zbatimit të këtij protokoll, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

2. Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë përfaqësues rregullisht të autorizuar të dy palëve, nënshkruajnë këtë protokoll në datën 16 tetor 2014, në Budva/Mali i Zi.

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi

Emri: Mimi Kodheli

Titulli: Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë

Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë

Nënshkrimi

Emri: Ismet Yilmaz

Titulli: Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë

#### DEKRET

Nr. 9002, datë 19.3.2015

#### PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrit të Punëve të Brendshme,

#### DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Suzana Ndue Lekaj
2. Ali Nusret Mamo
3. Zilbear Bari Ramadani
4. Mehmet Yusuf Zaif
5. Bayram Bahadır Feyzi Er
6. Abramo Giovanni (Giovanni) Bruno
7. Maria (Marija) Boris Tobak
8. Vjosa Mustafë Loci (Kelmendi)
9. Anita Salih Sallahi (Kuçi)



10. Hamdi Musa Shehu
11. Beqir Zeqir Hajdinaj
12. Hussam (Hossam) Erfan Mtawa
13. Arfan Hossam (Hussam) Mtawa
14. Fatima Alzahraa Hossam (Hussam) Mtawa
15. Saïdine Brahim Bouhia
16. Ahmed Nassar Abdelaziz
17. Al Chayma Mahmoud Samih Omar  
Muhammad Kassem
18. Fahruc Ismail Sylejmani
19. Adiat Muhamedi Domi
20. Flutura Xhavit Dibra (Brovina)
21. Egemen Serkan Mustafa Serbest

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**UDHËZIM**  
Nr. 4, datë 16.2.2015

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT  
FINANCIARE PËR ZBATIMIN E  
PROGRAMEVE TË NXITJES  
SË PUNËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012 " Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, që hyjnë për herë të parë në punë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012 "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

248, datë 30.4.2014 “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 17.1.1998, “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

**PJESA I**  
**KLASIFIKIMI BUXHETOR**

1. Për të realizuar me efikasitet më të madhe dhe për të ushtruar kontrollin mbi përdorimin e fondit të nxitjes së punësimit për projektet e këtij programi, fondet buxhetore, të cilat klasifikohen në grupin 25, titullin 10550, kap. 1. art. 603 “Subvencione”, do të detajohen më tej në nivel nënartikulli.

2. Ndryshimet në klasifikimin buxhetor janë kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

3. Detajimi i fondit të akorduar nga Buxheti i Shtetit, për programin e Nxitjes së Punësimit bëhet me miratimin e këshillit administrativ tripalësh, të ngritur pranë SHKP-së.

4. Drejtoritë rajonale të punësimit dhe zyrat vendore të punësimit do të mbajnë dhe do të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, shpenzimet e programit të nxitjes së punësimit deri në nivel nënartikulli, ndërkohë që dhe degët e thesarit do të mbajnë shpenzimet deri në nivel artikulli.

5. Detajimi i shpenzimeve të art. 603 “Subvencione”, në nënartikuj do të kryhet në kriteret e mëposhtme:

Artikulli 603.1 “Subvencion për të nxitur punësimin”

Në këtë artikull do të evidentohet totali i të gjitha shpenzimeve që kanë të bëjnë me “Programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, “Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar “Programin e nxitjes së punësimit të femra nga grupet e veçanta”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, “Për masën e financimit,





kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë, që hyjnë për herë të parë në punë”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale të punëkërkuësve të papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014 “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar.

Nënartikulli 6031100 “Shpenzime për paga”

Do të përbëhet nga pagat që do t’u jepen punëkërkuësve sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, pikës 1, "b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, sipas pikës 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, sipas pikës 1, "b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas pikës 1, "b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar dhe pikës 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, të ndryshuar.

Nënartikulli 6031200 “Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”

Do të përbëhet nga shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, masa e së cilës përcaktohet në udhëzimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për pikën 1 "a" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 2.4.2014, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27 datë 11.1.2012, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 189, datë 2.4.2014, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 2.4.2014, pikës 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 2.4.2014, për vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar dhe pika 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, të ndryshuar, paguhet kontributi për sigurimin nga aksidentet në punë.

Nënartikulli 6031300 “Mallra dhe shërbime të tjera”

Në mallra dhe shërbime të tjera do të futen gjithë pagesat që kanë të bëjnë me:

1. Shpenzimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për karburant, kancelari, njoftime, publikime etj. të këtij lloji;

2. Shpenzime për organizim kursesh dhe seminaresh apo aktivitete të tjera të këtij lloji. Këto shpenzime shërbejnë dhe janë në funksion të kuptimit të projekteve dhe kualifikimin e punonjësve që merren me to, si dhe të zbatimit, ndjekjes dhe kontrollit të projekteve në subjektet zbatuese, nga zyrat përkatëse të punësimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si institucion përgjegjës;

3. Shpenzime për vlerësimin e projekteve për vitin paraardhës;

4. Drejtoritë rajonale të punësimit do të paguajnë anëtarët e komisioneve tripalëshe për miratim projektesh një kuotë në masën 3000 (tre mijë) lekë, për çdo anëtar, por jo më shpesh se një herë në muaj;

Për këtë qëllim mbahet një procesverbal mbi pjesëmarrjen e anëtarëve, i cili firmoset nga anëtarë të komisionit, në rastet e mospjesëmarrjes në të tilla mbledhje, për çdo anëtar të komisionit nuk paguhet shuma përkatëse;

5. Theksojmë se këto shpenzime nuk do të konsiderohen si pjesë përbërëse direkte të një projekti, por si shtesë e programit të nxitjes së punësimit;

6. Këto shpenzime megjithëse kanë natyrë të njëjtë me shpenzimet “Mallra dhe shpenzime të tjera” të vetë administratës, do të dallohen nga ato dhe do të evidentohen në tit. 10550, kap. 1, art. 603, nënartikulli 6031300;

7. Për të shmangur abuzimet dhe keqkuptimet e mundshme vendosen norma të harxhimit të shpenzimeve;

Kufiri i masës së nënartikullit “Mallra dhe shërbime të tjera” në asnjë rast nuk e kalon nivelin deri në 4 % të financimit.

Nënartikulli 6031400 “Subvencion për të nxitur punësimin”

Subvencionet përbëhen nga pagesat që kryhen nga drejtoritë rajonale të punësimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave 248 datë 30.4.2014, të ndryshuar .



Ky subvencion t'ï xhirohet çdo muaj subjektit, që aplikon programin e nxitjes së punësimit. Për sa i përket vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, subvencionohet vetëm punëkërkuasi.

## PJESA II PROCEDURAT E FINANCIMIT

1. Një projekt i nxitjes së punësimit financohet nga drejtoritë rajonale të Punësimit, kur ai është miratuar nga:

a) Komisioni i vlerësimit i drejtorive rajonale të punësimit;

b) Komisioni i vlerësimit i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit;

c) Komisioni i vlerësimit i zyrave vendore të punësimit.

2. Drejtori i zyrës rajonale të punësimit nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave të financimit, për subjektet fituese të projekteve të nxitjes së punësimit, të miratuara nga komisioni i vlerësimit i drejtorive rajonale dhe i zyrave vendore të punësimit.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit nxjerr urdhër për fillimin e procedurave të financimit për subjektet fituese të projekteve të nxitjes së punësimit, të miratuara nga Komisioni i Vlerësimit i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

4. Konfirmimi i fondit për projektet e miratuara bëhet brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së kontratave përkatëse.

5. Për miratimin e projekteve fituese, zyra përkatëse e punësimit do të paraqesë pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, dokumentacionin që përcaktohet në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248 datë 30.4.2014, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

6. Drejtoritë rajonale të punësimit do të financojnë projektet e nxitjes së punësimit

(projektet e zyrave rajonale dhe zyrave vendore) sipas pikës 1 dhe 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, sipas pikës 1 “a” dhe “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, mbas datës 10 të çdo muaji për aktivitetin e muajit të mëparshëm. Për muajin dhjetor xhirimi i fondeve do të bëhet brenda datës 31 dhjetor.

7. Për kryerjen e financimeve si më lart, zyra rajonale e punësimit paraqet pranë degës së thesarit në rajon, si urdhër-pagesën të shoqëruar me urdhër-shpenzimin në favor të subjektit zbatues, listëpagesën e punëkërkuësve të marrë në punësim të përkohshëm, kontratën e lidhur me subjektin zbatues si dhe dokumentacionin e përcaktuar në udhëzimet e dala në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave të mësipërme, për projektet e zyrave rajonale dhe zyrave vendore.

a) Mbështetja financiare për punëkërkuësit që marrin pjesë në praktikën profesionale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, të kalojë në llogarinë bankare të secilit pjesëmarrës.

b) Drejtoria rajonale e punësimit, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritura sipas listëpagesave të hartuara nga subjekti zbatues, t'ï xhiron në degën e thesarit në rajon për projektet e zyrave rajonale dhe zyrave vendore.

8. Transferimet e fondeve të programit të nxitjes së punësimit, sipas projekteve fituese të miratuara në komisionet përkatëse, të kryhen duke zbatuar kufizimin kohor të përcaktuar në udhëzimin, e përvitshëm, të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit”.

9. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoritë Rajonale të Punësimit, Degët e Thesarit në Rajon, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave.

10. Udhëzimi nr. 1569, datë 30.7.2008 dhe nr. 5003/3, datë 28.7.2008 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe



Ministrit të Financave “Për kriteret dhe procedurat financiare për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE  
DHE RINISË  
**Erion Veliaj**  
MINISTRI I FINANCAVE  
**Shkëlqim Cani**

**VENDIM**  
**Nr. 12, datë 19.3.2015**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,  
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 23.10.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 46/14 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Rexhep Toska

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme

**OBJEKTI:** 1. Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut i vendimeve nr. 821, datë 19.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 61, datë 25.1.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-50, datë 16.1.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

2. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, që

kërkon rrëzimin e kërkesës, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 821, datë 19.5.2011, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit, Rexhep Toska, për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të këtij neni me 9 muaj burgim dhe 300.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së e dënon përfundimisht të pandehurin, Rexhep Toska, me 6 muaj burgim dhe 200.000 lekë gjobë.”*

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 61, datë 25.1.2012, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit.”*

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-50, datë 16.1.2014, mbi rekursin e ushtruar prej kërkuesit, vendosi: *“Mospranimin e rekursit.”*

**II**

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur argumentet e tij janë si vijon:

4.1 *Nuk është respektuar parimi i barazisë së palëve në gjykim.* Si një nga të pandehurit në këtë proces, kërkuesi pretendon se nuk është dëgjuar lidhur me pretendimin e prokurorit se ka përpiluar një dokument noterial duke përfshirë persona me identitet të rremë. Sipas tij, prokurori nuk ka kryer hetim të plotë të fakteve dhe provave, duke prezumuar se ka vepër penale pavarësisht se nuk argumenton elementet e veprës penale, si p.sh anën objektive dhe anën subjektive të saj. Gjykata ka pranuar apriori akuzat e prokurorisë pa ia nënshtruar debatit gjyqësor provat e marra nga prokuroria dhe në disa raste duke hamendësuar ekzistencën e provave.

4.2 *Arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë është kontradiktor dhe jologjik.* Gjykata, megjithëse ka dyshime për deklaratën e njërit prej të pandehurve në gjykim, e përfshin atë në vendim si provë në mbështetje të akuzës pa u ndaluar tek besueshmëria dhe vërtetësia e dëshmisë së tij, gjë e cila, sipas kërkuesit, bie ndesh jo vetëm me arsyetimin logjik të vendimeve gjyqësore por edhe me parimin e barazisë së palëve në gjykim.

4.3 *Nuk është respektuar e drejta për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë.* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,



sipas kërkesit, nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e tij dhe nuk i ka dhënë mundësinë të dëgjohet, me qëllim riparimin e shkeljeve të bëra nga dy gjykatat më të ulëta. Si gjykatë më e lartë, ajo duhej të riparonte shkeljet e bëra në gjykatat e tjera.

4.4 Nuk është zbatuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 26.7.2012 për mosdhënien e dy dënimeve penale. Kërkuesi ka parashtruar se Kolegji Penal duke mos e dëgjuar kërkuemin, nuk i ka dhënë atij mundësi të shprehet edhe lidhur me ndalimin e dhënies së dy dënimeve kryesore, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka shfuqizuar dispozitën e Kodit Penal që mundësonte dhënien e dy dënimeve kryesore.

### 5. Subjekti i interesuar ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

5.1 Pretendimi i kërkuemit për mohim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe barazi të armëve nuk qëndron, pasi ai ka qenë i pranishëm në të gjitha seancat dhe ka pasur mundësinë të shprehet për akuzat. Mosmarrja e kompjuterit nga prokuroria si provë materiale nuk tregon se atij nuk i është respektuar e drejta për t'u dëgjuar, por se prokurori nuk e ka parë të arsyeshme të bëjë një veprim të tillë.

5.2 Fakti që gjykata shprehet se dëshmia e dikujt mund të jetë kontradiktore duke e përdorur si burim për verifikimin e të dhënave të tjera, nuk do të thotë se arsyetimi i vetë gjykatës është kontradiktor. Gjykata është mbështetur edhe në prova të tjera për të arritur në përfundimin konkret për kërkuemin.

5.3 Kolegji Penal nuk mund të pranonte për gjykim rekursin e kërkuemit, pasi ky i fundit ka parashtruar vetëm pretendime që lidhen me analizën e provave dhe konsiderata të përgjithshme. Është në vlerësimin e atij Kolegji të çmojë nëse plotësohen kriteret e pranimit për gjykim të rekursit.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për legjitimitimin e kërkuemit

6. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës; *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe

*ratione materiae*, pasi pretendimet e tyre *prima facie*, përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

#### b) Për themelin e çështjes

1. Për pretendimin lidhur me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të drejtës për t'u dëgjuar nga gjykatat e shkallës së parë dhe apelit

7. Kërkuesi pretendon se gjykatat nuk kanë respektuar barazinë e armëve midis palëve duke mos marrë të gjitha provat e nevojshme për të arritur në përfundimin për përgjegjësinë penale të të akuzuarve. Sipas tij, prokuroria duhej të kishte marrë si provë kompjuterin e kërkuemit, me qëllim verifikimin e aktit të përpiluar prej tij.

8. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, parashtron se pretendimi i kërkuemit nuk qëndron, pasi kërkuesi ka qenë i pranishëm në të gjitha seancat dhe ka pasur mundësinë të shprehet për akuzat. Mosmarrja e kompjuterit nga prokuroria si provë materiale nuk tregon se atij nuk i është respektuar e drejta për t'u dëgjuar, por se prokurori nuk e ka parë të arsyeshme ta bëjë një veprim të tillë, për shkak se identifikimi i personit që kishte përpiluar aktin ishte bërë, gjithashtu edhe fakti i paligjshëm, pra falsifikimi i dokumentit zyrtar.

9. Gjykata në praktikë të vazhdueshme ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre, është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por, përkundrazi, duhet që në radhë të parë legjislacioni procedural, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin penal, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 12.6.2003; nr. 23, datë 8.6.2007;*



*nr. 34, datë 25.7.2011 dhe nr. 7, datë 10.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

10. Në jurisprudencën e saj të konsoliduar, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 38, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata, në vështrim të standardit të mësipërm, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuarit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, vlerëson se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit, gjë e cila është në kompetencë të gjykatave të zakonshme dhe jo të kësaj Gjykate.

2. Për pretendimin lidhur me mosarsyetim logjik të vendimeve të gjykatave

12. Kërkuar pretendon se vendimet e gjykatave të zakonshme (të rrethit dhe apelit) nuk janë arsyetuar në përputhje me standardet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese lidhur me këtë parim. Ato janë jologjike dhe kontradiktore. Sipas kërkuarit, gjykata, megjithëse kishte dyshime për deklaratën e njërit prej të pandehurve në gjykim, e përfshiu atë në vendim si provë në mbështetje të akuzës pa u ndaluar tek besueshmëria dhe vërtetësia e dëshmisë së tij. Një gjë e tillë, sipas kërkuarit, bie ndesh jo vetëm me arsyetimin logjik të vendimeve gjyqësore por edhe me parimin e barazisë së palëve në gjykim.

13. Subjekti i interesuar prapëson pretendimin duke argumentuar se fakti që gjykata shprehet se dëshmia e dikujt mund të jetë kontradiktore duke e përdorur si burim për verifikimin e të dhënave të tjera, nuk do të thotë se arsyetimi i vetë gjykatës është kontradiktor. Gjykata është mbështetur edhe në prova të tjera për të arritur në përfundimin konkret për kërkuar.

14. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit është i papabazuar. Pavarësisht paqëndrueshmërisë në deklaratat e dhëna nga një prej të pandehurve në gjykim, gjykata e ka analizuar



atë në kompleks me provat dhe faktet e tjera. Dëshmia e dhënë nga një i pandehur në gjykim nuk ka qenë e vetmja provë mbi të cilën është mbështetur vendimi i fajësisë së kërkuesit.

3. Për pretendimin lidhur me mosrespektimin e së drejtës për t'u dëgjuar në Gjykatë të Lartë dhe moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga ajo gjykatë

17. Kërkuesi pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të vendoste në dhomë këshillimi, por duhej ta kishte shqyrtuar në seancë rekursin e tij, pasi ai përmbante shkaqe që lidheshin me shkelje konkrete të rregullave procedurale penale. Nëse një gjë e tillë do të ishte bërë nga Gjykata e Lartë, atëherë kërkuesi do të kishte pasur mundësi të kërkonte edhe prishjen e vendimit të gjykatës së apelit për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka hyrë në fuqi para se të shqyrtohej rekursi në Gjykatë të Lartë. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar vendimin nr. 47/2012 të Gjykatës Kushtetuese, që ka vendosur shfuqizimin e neneve 190 dhe 191 të Kodit Penal, të cilat parashikonin dhënien e dy dënimeve kryesore, pra dënimin me gjobë krahas atij me burgim.

18. Subjekti i interesuar parashtrori se Kolegji Penal nuk mund të pranonte për gjykim rekursin e kërkuesit, pasi ky i fundit kishte parashtruar vetëm pretendime që lidhen me analizën e provave dhe konsiderata të përgjithshme. Ishte në vlerësimin e atij Kolegji të çmonte nëse plotësohen kriteret e pranimit për gjykim të rekursit.

19. Gjykata është shprehur edhe herë të tjera për rolin që ka dhoma e këshillimit në Gjykatë të Lartë, duke vlerësuar se sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 4,*

*datë 25.2.2009 dhe nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Nga kjo praktikë rezulton se çështja e aksesit në Gjykatën e Lartë nuk mund të vlerësohet në këtë këndvështrim nga Gjykata Kushtetuese, pasi faza e seleksionimit është vlerësim i vetë Kolegjit përkatës. Megjithatë, Gjykata e shih me vend të ndalet në pretendimin lidhur me moszbatimin e vendimit të kësaj Gjykate për sa i takon dhënies së dy dënimeve penale si dënime kryesore.

21. Gjykata konstaton se kërkuesi është dënuar nga gjykatat e faktit me 6 muaj burgim dhe 200.000 lekë gjobë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mbi rekursin e kërkuesit pas daljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe për këtë shkak, ai (Kolegji) duhej të kishte marrë parasysh faktin se Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar dispozitat penale mbi bazën e të cilave kërkuesi ishte dënuar.

22. Pavarësisht se kërkuesi nuk e ka parashtruar në rekurs këtë fakt, për shkak se rekursi ishte ushtruar para hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkuesi nuk mund të ishte në dijeni të tij, Kolegji Penal *ex officio* duhej të kishte vlerësuar antikushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të faktit, pasi çështja ishte ende në gjykim para Kolegjit Penal.

23. Gjykata në vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 ka mbajtur qëndrimin se përcaktimi paraprakisht nga ligjvënësi i dënimit me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burg, në një sërë dispozitash penale, ndërhyr në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin në rastin konkret të dënimit. Më tej, Gjykata ka arsyetuar se secili prej dënimeve kryesore të parashikuara nga neni 29 i KP-së, të zbatuara kur është nevoja së bashku me dënimet plotësuese si dhe me dënimin me gjobë sipas parashikimit të nenit 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të KP-së, është i mjaftueshëm në arritjen e qëllimit të dënimit penal dhe në proporcion me parimet e legjislacionit penal, duke respektuar njëkohësisht parimin e ndarjes së pushteteve. Për pasojë, parashikimi *a priori* i dy dënimeve kryesore nuk është proporcional si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimit e, si rrjedhojë, me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim.



24. Pas deklarimit nga kjo Gjykatë të antikushtetutshmërisë së nenit 29, paragrafi i fundit, të KP-së, ajo (Gjykata) ka theksuar në çështje të tjera se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit konkret të veprave penale, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore, në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e Pjesës së Posaçme të KP-së. Në këto raste, gjykatat duhet të aplikojnë vetëm dënimin me burgim dhe, nëse plotësohen kushtet e sanksionuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së, në bazë të vlerësimit konkret të rrethanave të çështjes, ato mund të aplikojnë krahas dënimin me burgim edhe dënimin me gjobë, kur vepra penale passjell përfitime materiale për autorin e saj. Gjykata, po ashtu, thekson se neni 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, i KP-së aplikohet si në rastet kur dispozitat e KP-së përcaktojnë si dënim për veprën penale vetëm atë me burgim, ashtu dhe në rastet kur ato (dispozitat) sanksionojnë njëkohësisht dy dënime kryesore.

25. Gjykata, në praktikën e saj, ka vlerësuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë të gjitha mundësitë me parashikimet aktuale të KP-së të japin dënimin me burgim si dënim kryesor, në të gjitha rastet e përcaktimit të dy dënimeve kryesore në dispozitat e Pjesës së Posaçme të KP-së, si dhe ta ashpërsojnë atë me dënimin me gjobë kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së (*Shih vendimin nr. 13, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Sipas Gjykatës, dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimin për autorët e veprave penale.

27. Gjykata çmon se vlerësimi i tërësisë së faktit penal, në lidhje me të gjitha elementet dhe rrethanat që e përbëjnë atë, me qëllim individualizimin e shkallës së përgjegjësisë të të pandehurit dhe përshtatshmërinë e dënimin, hyn në fushën e diskrecionalitetit të gjyqtarit të faktit, kurse Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka në kompetencë të

shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural dhe kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. (*shih vendimet nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 13, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këtë kuptim, në rastin konkret, Gjykata e Lartë, duhet t'i kishte vlerësuar shkaqet e rekursit jo vetëm në kuadër të mangësive ligjore apo zbatimit të gabuar të ligjit, siç parashikon KPP-ja, por edhe në kuadër të zbatimit të drejtë dhe koherent të dispozitave ligjore për dhënien e dënimin penal, baza ligjore e të cilit, në kohën e shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi, kishte ndryshuar si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Çështja e zbatimit të drejtë të ligjit procedural është një nga shkaqet për të cilat rekursi duhet të kalojë për shqyrtim gjyqësor në seancë publike në Gjykatën e Lartë.

29. Nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në Gjykatën e Lartë është i bazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P”, dhe nenit 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-50, datë 16.1.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), për pjesën në ngarkim të kërkuesit Rexhep Toska.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Vitore Tusha



**VENDIM**  
**Nr. 13, datë 19.3.2015**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 20.1.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 65/32 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Teki Muhameti

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2014-937, datë 19.6.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 228, datë 15.5.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenet 27-30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi Teki Muhameti është gjykuar dhe dënuar për kryerjen e krimit të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal. Për këtë vepër penale në datën 15.07.2010 kërkuesi është kallëzuar nga shtetasit Arben Muhameti dhe Dhimitraq Muço, me pretendimin se ai (*kërkuesi*) ka pasur në përdorim dokumente të falsifikuara dhe konkretisht

kontratën e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme nr. Rep 638, nr. Kol 548, datë 22.11.2007. Kallëzuesit e kësaj vepre penale rezultojnë të jenë trashëgimtarë të radhës së parë, respektivisht të të ndjerëve Ferik Muhameti e Mama Muhameti (Muço). Këta të fundit, së bashku me kërkuesin, Teki Muhameti, Merfa Muhametin (Pushi) dhe Sanie Muhametin, janë trashëgimtarë ligjorë të shtetasit Shaban Muhameti dhe në këto rrethana trashëgojnë në pjesë të barabarta pasurinë tokë truall prej 1560 m<sup>2</sup> të ndodhur në lagjen “Pavarësia” të qytetit të Vlorës. Objekt i kallëzimit ka qenë kontrata e pjesëtimit të kësaj pasurie, pasi sipas kallëzuesve Arben Muhameti dhe Dhimitraq Muço, kjo kontratë ka qenë e falsifikuar, sepse në të nuk ka firmosur shtetasi Ferik Muhameti, pasi nuk ka qenë prezent te noteri, dhe shtetasja Mama Muhameti (Muço), e cila rezulton të ketë vdekur në vitin 1988, pra disa vite përpara kontratës.

2. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pas hetimeve lidhur me këtë fakt, ka arritur në përfundimin se kontrata e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme nr. Rep 638, nr. Kol 548, datë 22.11.2007 është e falsifikuar, pasi nuk është firmosur nga të gjithë bashkëpronarët. Në këto kushte, prokuroria ka kërkuar gjykimin e të pandehurit Teki Muhameti (*kërkuesi*) për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 493, datë 30.11.2011, ka vendosur *inter alia* deklarinimin fajtor të të pandehurit Teki Muhameti për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve me anë të përdorimit, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 9 (nëntë) muaj burgim dhe 500 000 lekë gjobë.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 288, datë 15.5.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit *supra* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-937, datë 19.6.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

**II**

**Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese**

6. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore





objekt kërkese, duke pretenduar se këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

6.1 Është shkelur e drejta e mbrojtjes, pasi është gjykuar në mungesë, si rezultat i mospërmbushjes nga organet shtetërore të detyrimit për vënien në dijeni për procesin gjyqësor në ngarkim të tij.

6.2 Është shkelur e drejta për t'u dëgjuar, pasi si rezultat i mungesës së njoftimit efektiv për procesin gjyqësor në ngarkim, ai nuk ka pasur mundësi të mbrohet në gjykim.

6.3 Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi nuk i është dhënë mundësia që të dëgjohen argumentet e tij.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkesit

7. Gjykata vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individi, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2014-937, datë 19.6.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (*dhomë këshillimi*).

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata rithekson se ajo ndërhyr në ato raste kur përmes veprimeve të tyre gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i

gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata konstaton se argumentet e kërkesit në mbështetje të parregullsive të gjyimit në apel dhe në Gjykatën e Lartë lidhen me mosnjoftimin e kërkesit për seancën gjyqësore në ngarkim të tij, duke i mohuar atij disa të drejta themelore të parashikuara në Kushtetutë, si e drejta për t'u mbrojtur, e drejta për t'u dëgjuar, etj. Në këto kushte, nisur nga natyra e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon se vlerësimi i tyre përfshihet në juridiksionin kushtetues.

##### B. Mbi themelin e pretendimeve

11. Kërkuksi ka argumentuar se për shkak të mungesës së tij në gjykim, si rrjedhim i mosnjoftimit nga Gjykata e Apelit Vlorë, atij i janë mohuar disa të drejta themelore të parashikuara në Kushtetutë, si e drejta për t'u mbrojtur, e drejta për t'u dëgjuar, si dhe është shkelur parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim. Në këtë kuptim edhe Gjykata e Lartë ka gabuar duke vendosur mospranimin e rekursit, pasi kërkesa për pavlefshmërinë e seancës gjyqësore të zhvilluar në apel jo vetëm që pasqyrohet në rekurs, por është një çështje që duhej të ishte ngritur edhe kryesisht nga Gjykata e Lartë.

12. Gjykata, bazuar në pretendimet e kërkesit dhe argumentet mbi të cilat ato mbështeten, vlerëson se këto pretendime duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

13. Gjykata rikonfirmon qëndrimin se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë, që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. E drejta e një personi të



akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. *(shih vendimin nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Në konceptin e të drejtës për t'u mbrojtur përfshihet e drejta për t'u mbrojtur vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij. Mbrojtja vetë është pjesë e rëndësishme e të drejtës së mbrojtjes në kuptimin që jep edhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që garanton të drejtën për proces të rregullt. Në paragrafin e parë të këtij neni thuhet ndër të tjera se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht ndërsa në paragrafin e tretë pika "c" të po këtij neni, duke iu referuar çështjeve penale, thuhet se çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij.

15. Në nenin 31/ç të Kushtetutës parashikohet se në procesin penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, ndërsa në nenin 33/1, duke iu referuar sërish procesit penal, deklarohet se kushdo ka të drejtë të dëgjohej para se të gjykohej. Në këtë mënyrë deklarohet një e drejtë kushtetuese me rëndësi thelbësore, e drejta e të pandehurit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur vetë ndaj akuzës së bërë ndaj tij. Pjesëmarrja e të pandehurit në seancë gjyqësore dhe mundësia e mbrojtjes vetë janë padyshim elemente të rëndësishme të së drejtës për proces të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Nga ana tjetër, deklaratimet e të pandehurit në seancë, pavarësisht se ai mund të mbrohet njëkohësisht edhe nga një avokat, i shërbejnë vetë gjykimit të çështjes. Ato shërbejnë për të saktësuar e sqaruar më mirë mjaft elemente të veprës penale, si rrethanat e kryerjes së saj, motivet, formën dhe shkallën e fajësisë, të cilat, marrë në tërësi, do të ndikojnë dukshëm edhe në fatin e akuzës, kualifikimin e veprës, si dhe llojin dhe masën e dënimit *(shih vendimin nr. 25, datë 30.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese).*

16. Për palën në proces heqja e mundësisë që nëpërmjet përfaqësimit të mbrojtjes interesat e veta në gjykim, është konsideruar shkelje e standardeve të procesit të rregullt ligjor në jurisprudencën e Gjykatës. Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgohen njëjloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës

palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër. *(shih vendimin nr. 5, datë 17.3.2003 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Gjykata vëren se e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim i ngarkon autoritetet me detyrën që të njoftojnë të akuzuarin në kohë të mjaftueshme për datën dhe orën e seancave gjyqësore, të kërkojnë praninë në to të të akuzuarit dhe të mos e përjashtojnë padrejtësisht nga gjykimi. Për këtë arsye, Gjykata çmon të vlerësojë nëse Gjykata e Apelit Vlorë ka përbushur efektivisht detyrimin për njoftimin e kërkuarit.

18. Referuar dosjes gjyqësore, gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë rezultoi se në ngarkim të kërkuarit janë zhvilluar disa seanca gjyqësore. Sipas dëftësive të komunikimit rezultoi se seanca e parë gjyqësore i është komunikuar kërkuarit dhe mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Në seancën e datës 12.4.2012 ka rezultuar se mbrojtësi i kërkuarit ka hequr dorë nga përfaqësimi i tij dhe si rrjedhim gjykata ka vendosur të vazhdojë gjykimin në mungesë të kërkuarit dhe të caktojë një mbrojtës kryesisht. Në këto kushte, seanca e radhës i është komunikuar me fletëthirrje mbrojtësit kryesisht dhe avokatit të zgjedhur prej tij, edhe pse ky i fundit ka hequr dorë nga mbrojtja. Kjo seancë është zhvilluar në datën 25.4.2012, ku ka qenë prezent djali i kërkuarit, i cili ka paraqitur një raport mjekësor ku justifikohet mungesa e të pandehurit Teki Muhameti. Në kushtet kur ky i fundit ka kërkuar të paraqitet personalisht në gjykatë, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës. Sipas procesverbalit gjyqësor të kësaj seance, njoftimin e të pandehurit e ka marrë përsipër djali i tij Genci Muhameti. Seanca e radhës, datë 9.5.2012 është shtyrë për në datën 23.5.2012 *(palët kanë marrë dëgjimin në seancë)*, pasi kërkuari ka pretenduar mbrojtjen e tij me avokat të zgjedhur prej tij. Në fakt, kjo seancë gjyqësore rezultoi të jetë zhvilluar në datën 15.5.2012, nga ku konstatohet se interesat e kërkuarit janë mbrojtur me avokat të caktuar kryesisht, pasi kërkuari nuk është paraqitur dhe përfaqësuesi i tij, i ndodhur rastësisht në gjykatë, ka pretenduar para gjykatës padijeninë e tagrave të tij përfaqësues në këtë çështje.

19. Sipas Kodit të Procedurës Penale, organet dhe mënyrat e njoftimit të akteve janë të përcaktuara në nenin 132 të këtij kod, ku ndër të



tjera parashikohet se njoftimet që u bëhen nga gjykata të interesuarve në praninë e tyre shënohen në procesverbal. Referuar procesverbalit të datës 9/5/2012 rezulton se gjykata ka zbatuar këtë dispozitë procedurale për të realizuar njoftimin e palëve për seancën gjyqësore të radhës. Sipas shënimeve në këtë procesverbal, seanca e radhës ishte caktuar të zhvillohej në datën 23/5/2012, ndërkohë që nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk është respektuar kjo datë e gjykimit të çështjes, pasi seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 15/5/2012 dhe jo në 23/5/2012, sikurse palët kishin marrë njoftim në seancë gjyqësore. Në këtë mënyrë është evident fakti që Gjykata e Apelit Vlorë e ka zhvilluar procesin duke administruar vetëm argumentet e prokurorit, pa dëgjuar më parë edhe pretendimet e kërkuesit.

20. Në vështrim të standardeve kushtetuese dhe kërkesave procedurale penale lidhur me njoftimin e të pandehurit, Gjykata arrin në konkluzionin se shkeljet procedurale në drejtim të rregullave të njoftimit tregojnë mungesën e njoftimit efektiv dhe zyrtar të kërkuesit gjatë gjykimit, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë duhet të shfuqizohet.

21. Për sa i përket shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, Gjykata konstaton se gjatë këtij procesi gjyqësor nuk janë korrigjuar mangësitë procedurale të gjykimit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata ka theksuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi si i tërë ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Gjykata ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 5 datë 25.2.2013*). Në kushtet kur pretendimet e kërkuesit janë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, madje janë evidentuar si shkelje procedurale edhe në rekursin e paraqitur nga organi i prokurorisë, Gjykata vlerëson se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t'u dëgjuar në gjykim dhe

njëkohësisht të drejtën e ankimit efektiv në një gjykatë më të lartë. Si rrjedhim, Gjykata arrin në përfundimi se edhe Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues, për pasojë vendimi duhet të shfuqizohet.

22. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në Gjykatën e Lartë, kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të mospjesëmarrjes në gjykimin në apel dhe (mos)garantimit të së drejtës të mbrojtjes dhe të drejtës për t'u dëgjuar, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2014-937, datë 19.6.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 228, datë 15.5.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

#### KËRKESË

Shtetasi Ragip Uligaj, i biri i Ymerit dhe i Fatimes, i datëlindjes 31.1.1931, lindur në Shkodër dhe banues në Dobraq, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të zhdukur të djalit të tij, shtetasit Agim Uligaj, i datëlindjes 31.5.1966, Shkodër.

KËRKUES  
Ragip Uligaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë